



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË**

Nr. 1772 prot.

Tiranë, më 25.06.2024

NJOFTIM ME SHPALLJE

TË VENDIMIT NR. 3040/3, DATË 24.11.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, “PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESAVE TË BASHKUARA TË PARAQITURA NGA ZNJ. NATASHA DEDJA PËR DISA NGA PRETENDIMET E NGRITURA NË ANKESA”

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga znj. Natasha Dedja me nr. 3066 prot., datë 05.07.2021, nr. 3066/2 prot., datë 26.07.2021, nr. 3066/3 prot., datë 07.10.2021, nr. 3066/3 prot., datë 30.12.2021, nr. 3066/4 prot., datë 01.12.2021, nr. 2231 prot., datë 04.08.2022 dhe nr. 2295 prot., datë 24.08.2022, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistrateve O.L. dhe S.H. me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe A.C. me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar dhe me vendimin nr. 3040/3 prot., datë 24.11.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasja znj. Natasha Dedja për disa nga pretendimet e ngritura në ankesa”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi; Rruga: “Prokop Mima”, Ndërtesa 33, Hyrja 17, Apartamenti nr. 39, Selitë, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al.

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

